



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.50

2006

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr.4883 datë 16.5.2006	Për lirim ambasadori..... 1467
Vendim i KM nr.269, datë 10.5.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.503, datë 30.6.2005 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara”, të ndryshuar..... 1467
Vendim i KM nr.271, datë 10.5.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.54, datë 28.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për dhënien e lejeve profesionale specialistëve, që kryejnë projektimin, vlerësimin, konsulencën, monitorimin dhe drejtimin teknik të veprimtarisë minerare”..... 1468
Vendim i KM nr.272, datë 10.5.2006	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.644, datë 13.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 400/110 kV, në Zëmlak”... 1468
Vendim i KM nr.273, datë 10.5.2006	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional..... 1471
Vendim i KM nr.274, datë 10.5.2006	Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Sevasti&Parashqevi Qiriazi”..... 1472

Vendim i KM nr.280, datë 10.5.2006	Për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive.....	1473
Udhëzim i MB nr.806, datë 3.5.2006	Për plotësimin e adresës shifrore zgjedhore të shtetasve me adresë shifrore zgjedhore jo të plotë (të ashtuquajturat “rastet 999”).....	1473
Udhëzim i MB nr.807, datë 3.5.2006	Për administrimin dhe përditësimin e përbërësve zgjedhorë të regjistrit të përkohshëm të shtetasve të paregjistruar në regjistrin themeltar të gjendjes civile të vendbanimit.....	1481
Udhëzim i MB nr.873, datë 15.5.2006	Për procedurat e pastrimit të dublimeve në regjistrat themeltarë të identifikuar nga listat e zgjedhësve për zgjedhjet e 3 korrikut 2005.....	1489
Vendim e ERE nr.28, datë 12.5.2006	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, të prodhuar në HEC Vithkuq, nga shoqëria Favina sh.p.k. dhe Favina 1 sh.p.k.....	1493
Vendim e ERE nr.29, datë 15.5.2006	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit.....	1493

DEKRET
Nr. 4883, datë 16.5.2006

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Shaqir Vukaj, lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën Çeke.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 269, datë 10.5.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.503, DATË 30.6.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN, KOMPETENCAT DHE FUNKSIONIMIN E
AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE
KONFISKUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 36 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.503, datë 30.6.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, më poshtë “Agjencia”, është pjesë përbërëse e aparatit të Ministrisë së Financave.”.

b) Paragrafi i dytë i pikës 4, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 271, datë 10.5.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.54, DATË 28.1.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E LEJEVE
PROFESIONALE SPECIALISTËVE, QË KRYEJNË PROJEKTIMIN, VLERËSIMIN,
KONSULENCËN, MONITORIMIN DHE DREJTIMIN TEKNIK TË VEPRIMTARISË
MINERARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 “Minerar i Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr.54, datë 28.1.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Procedurat për dhënien e lejes profesionale specialistëve, që kryejnë projektimin, vlerësimin, konsulencën, monitorimin dhe drejtimin teknik të veprimtarisë minerare, përcaktohen me rregullore, e cila miratohet nga Ministri.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 272, datë 10.5.2006

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.644, DATË 13.12.2002 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
NËNSTACIONIT 400/110 KV, NË ZËMBLAK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 124 e 129 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, dhe të neneve 4, 5, pika 1, 8 shkronja “c”, 18, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.644, datë 13.12.2002 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Zhvlerësimin, për interes publik, të pasurive dhe të veprimtarisë së kantierit të prodhimit të materialeve të ndërtimit, pronë e shoqërisë “Grand-Inert”, sh.p.k., Korçë, për shkak të funksionimit, brenda kushteve teknike, të nënstacionit 400/110 kV, Zëmlak, Korçë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Shpronësimi dhe zhvlerësimi të bëhen në favor të KESH sh.a.-së, Tiranë.”.

3. Në pikën 3, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Shoqëria “Grand-Inert”, sh.p.k., Korçë, pasuria dhe veprimtaria e së cilës zhvlerësohet, të kompensohet në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme 22 337 074 (njëzet e dy milionë e treqind e tridhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë brenda muajit qershor 2006.”.

4. Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Fondet, për realizimin e shpronësimit dhe të procedurës së zhvlerësimit, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, miratuar për KESH sh.a., Tiranë, zëri “Kosto lokale për shpronësime.”.

5. Pas pikës 5 shtohet pika 5.1, me këtë përmbajtje:

“5/1.Vlera e shpenzimeve procedurale, për realizimin e procedurës së zhvlerësimit, në shumën 188 000 (njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, të jetë në ngarkim të KESH sh.a.-së si subjekt kërkues i këtij zhvlerësimi.”.

6. Në pikën 7, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Zhvendosja e kantierit të prodhimit të materialeve të ndërtimit, pronë e shoqërisë “Grand-Inert”, sh.p.k., Korçë, të fillojë brenda muajit maj 2006 dhe të përfundojë brenda muajit qershor 2006.”.

7. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Korçë, të bëjë çregjistrimin nga regjistrat e pasurive të paluajtshme të pronës “Ndërtesa”, të shoqërisë “Grand-Inert”, sh.p.k., Korçë, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, brenda muajit maj 2006.”.

8. Pika 8 ndryshohet si më poshtë vijon:

“8. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, KESH sh.a, Tiranë dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS**

LISTA E TË DHËNAVE, TË PASURISË DHE AKTIVITETIT TË SHOQËRISË “GRAND-INERT” SH.P.K KORÇË, E CILA ZHVLERËSOHET, PËR SHKAK TË FUNKSIONIMIT TË “NËNSTACIONIT 400/110 KV ZEMBLAK-KORÇË”.

**RRETHI: KORÇË
FSHATI: ZEMBLAK**

Lloji i pasurisë që zhvlerësohet: “Kantier Prodhim Material Ndërtimi”, pronë e shoqërisë “GRAND INERT” sh.p.k KORÇË

Nr.	PËRFAQËSUESI LIGJOR I SHOQËRISË “GRAND INERT” sh.p.k KORÇË	AKTIVITETI I SHOQËRISË PASURIA E TË CILËS ZHVLERËSOHET	PËRBËRIA DHE LLOJI I PASURISË QË ZHVLERËSOHET	Numrat e Pasurive, që zhvlerësohen, pronë e shoq. “Grand Inert” sh.p.k Korçë, (Kantier, prodhim material ndërtimi) Korçë	Zona Kadastrale	Vol.	Faqja	Sipërfaqja në m ² , për çdo pasuri	Vlera Totale e Kompensim it në lekë	Adresa
			Tokë Atë	89/41	3903	16	104	80		
			Truall	249/14	3903	16	225	617,2		
			Truall	249/15	3903	16	226	293,5, nga kjo 21 m ² ndërtesë		
			Truall	249/16	3903	16	227	300,9		
			Truall	249/17	3903	16	228	182		
			Ndërtesë	249/20	3903	16	105	29		
			Ndërtesë	249/21	3903	16	106	143		
			Ndërtesë	249/22	3903	16	107	12,6		
			Ndërtesë	248/1	3903	16	108	37,5		
	Totali								22.337.074	Zemblak-Korçë

(njëzetedymilion e treqindëtridhjetëshehatëmijë e shtatëdhjetëkatër) lekë

Sqarime:

Shpenzime procedurale: Publikime 168.000 (njëqindëgjashëtdhjetëtetëmijë) lekë.

Shpërbllim i anëtarëve të komisionit të posaçëm 20.000 (njëzetëmijë) lekë.

Shënime:

Pasuria e tipit “Tokë Truall” dhe “Tokë Bujqësore”, ngelet në pronësi të shoqërisë “Grand-Inert” sh.p.k Korçë, por pa të drejtë për të ndërtuar mbi të.

VENDIM
Nr. 273, datë 10.5.2006

**PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT
PROFESIONAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh” të nenit 7 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional, si institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2. Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional ka objekt kryesor të veprimtarisë krijimin e një sistemi kombëtar e unik të kualifikimeve profesionale, të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional harton programe për realizimin e politikave për zhvillimin e arsimit dhe formimit profesional, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Funksionet kryesore të Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional janë:

- a) hartimi dhe rishikimi i listës kombëtare të profesioneve dhe i përshkrimeve përkatëse;
- b) hartimi dhe rishikimi i kuadrit kombëtar të kualifikimeve profesionale (KKKP) me përshkrimin e standardeve për nivelet dhe drejtimet, si dhe i kriterëve të vlerësimit e certifikimit;
- c) hartimi dhe rishikimi i skeletkurikulave të kualifikimeve profesionale;
- ç) akreditimi i institucioneve, që ofrojnë arsimim dhe formim profesional;
- d) përcaktimi i standardeve të trajnimit, fillestar dhe të vazhdueshëm, të personelit mësimdhënës të arsimit dhe formimit profesional;
- dh) përcaktimi i kriterëve për vlerësimin dhe certifikimin e arsimit dhe formimit profesional;
- e) ndërtimi dhe rifreskimi i bazës së të dhënave për kuadrin kombëtar të kualifikimeve profesionale (KKKP), për skeletkurrikulat, akreditimin, certifikatat e dhëna, nevojat për kualifikime profesionale etj., që lidhen me arsimin dhe formimin profesional.

4. Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional raporton, në mënyrë periodike, në Këshillin Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional për çështjet e veprimtarisë së vet.

5. Funksionimi i Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional bëhet në përputhje me rregulloren, e cila, pas këshillimit me Këshillin Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional, miratohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

6. Ministri i Arsimit dhe Shkencës, mbështetur edhe në sugjerimet e Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional, i propozon Kryeministrit strukturën dhe organikën e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional.

7. Organika dhe numri i punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional të jenë brenda numrit të përgjithshëm të punonjësve të sistemit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2006, për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, e cila të çelë një zë të veçantë në buxhetin e vet për Agjencinë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional.

9. Emërimi dhe lirimi nga detyra i Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional bëhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrave”.

Para nxjerrjes së aktit të emërimit, lirimit ose shkarkimit nga detyra të Drejtorit të Agjencisë, Ministri i Arsimit dhe Shkencës këshillohet me Këshillin Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional.

10. Për nëpunësit e Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional respektohen procedurat e parashikuara në ligjin 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 274, datë 10.5.2006

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE,
JOPUBLIKE “SEVASTI & PARASHQEVI QIRIAZI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare, jopublike “Sevasti&Parashqevi Qiriazi”, me seli qendrore në Tiranë, Kodër Kamëz.

2. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Sevasti&Parashqevi Qiriazi”, do të ketë Fakultetin Ekonomik, me degët:

- Menaxhim biznesi (4 vite);
- Drejtues finance (4 vite);
- Drejtues kontabiliteti (4 vite).

3. Në mbarim të ciklit të parë të studimeve, të cilat do të zgjasin 4 vjet, shkolla e lartë universitare, jopublike “Sevasti&Parashqevi Qiriazi” do të japë diplomë universitare “Bachelor”, në titujt:

- Menaxhim biznesi;
- Drejtues finance;
- Drejtues kontabiliteti.

4. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Sevasti&Parashqevi Qiriazi” do të fillojë veprimtarinë në vitin akademik 2006-2007 dhe do të ketë sistemin e studimeve me dhe pa shkëputje nga puna.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës të kryejë procesin e vlerësimit dhe të akreditimit të kurseve të studimit dhe të ndjekë zbatimin e ligjshmërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 280, datë 10.5.2006

PËR CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT
MBIKËQYRËS SË AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KREDIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive shpërblehen, për pjesëmarrje në këtë këshill në raportin: kryetari 30 për qind të pagës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe anëtarët 20 për qind të pagës së Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj ministrie.

2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Trajtimit të Kredive përfitojnë shpërblim, vetëm për pjesëmarrje në mbledhjet e këshillit. Kur Këshilli Mbikëqyrës zhvillon më tepër se një mbledhje në muaj, anëtarët përfitojnë shpërblim, sipas kuotës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, vetëm për mbledhjen e parë.

3. Ngarkohet Agjencia e Trajtimit të Kredive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 prill 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

U D H Ë Z I M
Nr. 806, datë 3.5.2006

PËR PLOTËSIMIN E ADRESËS SHIFRORE ZGJEDHORE TË SHTETASVE ME ADRESË
SHIFRORE ZGJEDHORE JO TË PLOTË (TË ASHTUQUAJTURAT “RASTET 999”)

Me qëllim plotësimin e adresës shifrore zgjedhore të shtetasve, të cilët në listat e zgjedhësve të zgjedhjeve të vitit 2005 figurojnë me adresë shifrore zgjedhore jo të plotë (të ashtuquajturat "rastet 999"),

në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 53, pika 3, nenit 178, pika 2/3 të ligjit nr.9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenit 16, pika 1 të ligjit nr.8927, datë 25.07.2002 "Për prefektin" dhe ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile" i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) brenda 24 orëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi përgatit dhe u dërgon kryetarëve të njëjstëve të Qeverisjes Vendore (NJQV) listat përkatëse të shtetasve të cilët në listën përfundimtare të zgjedhësve të zgjedhjeve 2005 i kanë tre shifrat e fundit të adresës shifrore zgjedhore “999”.

2. Kryetari i NJQV-së, menjëherë pas marrjes së listës sipas pikës 1, vepron si më poshtë:

a) brenda 3 ditëve, nxjerr dhe shpall urdhër për pezullimin e dhënies së shërbimit nga Zyrrat e Gjendjes Civile (ZGJC), si edhe nga të gjitha zyrrat e tjera të NJQV-së, shtetasve me adresë shifrore zgjedhore jo të plotë, deri në deklarimin prej tyre të adresës pranë ZGJC-ve, zyrës së urbanistikës ose zyrrave të tjera të NJQV-së. Shtetasi deklaron adresën e tij sipas formularit "A/U-999" bashkëngjitur, dhe e konfirmon atë pranë zyrës së urbanistikës;

b) urdhëron Zyrën e Gjendjes Civile (ZGJC), që brenda 15 ditëve për shtetasit me adresë shifrore zgjedhore jo të plotë, por të cilët kanë, në regjistrin themeltar njërin nga anëtarët e familjes me adresë shifrore zgjedhore të plotë, t'u caktojë të njëjtën adresë shifrore zgjedhore. Për çdo ndryshim të kryer, ZGJC-ja informon kryetarin sipas formularit "B/U-999" bashkëngjitur;

c) ngarkon administratorët e lagjeve/kryetarët e fshatrave, ose punonjës të tjerë të administratës së tij, kur është e domosdoshme, që të gjejnë dhe të plotësojnë adresat e vendbanimit të familjeve të cilat kanë të gjithë anëtarët me kodin "999". Për këtë qëllim, mund të shfrytëzohen të dhënat e institucioneve dhe/ose enteve të tjera sipas radhës, si: KESH, Albtelecom, Albaposta, zyrrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ndërmarrjet ujësjellës-kanalizime, institucionet e shërbimit shëndetësor parësor, shkollat etj. Kryetarët e NJQV-ve kur hasin vështirësi, kërkojnë ndihmën e prefektit për të mundësuar bashkëpunimin me institucionet e sipërpërmendura. Informacioni i mbledhur i dorëzohet kryetarit të NJQV-së sipas formularit "C/U-999" bashkëngjitur;

ç) urdhëron zyrën e urbanistikës të saktësojë adresat shifrore zgjedhore mbi bazën e deklarimeve të shtetasve sipas formularëve "A/U-999" dhe të ndihmojnë administratorët e lagjeve/kryetarët e fshatrave për plotësimin e adresat shifrore zgjedhore në formularët "C/U-999";

d) urdhëron ZGJC-të të pasqyrojnë në regjistrin themeltar adresat shifrore zgjedhore të plotësuar sipas germave (b) dhe (c) të kësaj pike, dhe ta informojnë atë me shkrim sipas formularit "D/U-999" bashkëngjitur.

3. Kryetari i NJQV-së plotëson formularin "E/U-999" bashkëngjitur, si dhe informon me shkrim për ecurinë e procesit çdo të martë prefektin e qarkut duke i bashkëngjitur në çdo rast formularin "D/U-999" të plotësuar.

4. Prefekti i qarkut kontrollon saktësinë e plotësimin të formularëve "E/U-999" dhe i dërgon çdo të enjte një informacion përmbledhës DPGJC-së, sipas formularit "F/U-999" bashkëngjitur.

5. Prefektët ngarkojnë përgjegjësit e degës së gjendjes civile në qark për të kontrolluar, verifikuar dhe ndihmuar punonjësit e ZGJC-ve në lidhje me reflektimin e plotësimeve të mësipërme në regjistrat themeltarë.

6. Në rast shkeljeje të detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim, personat përgjegjës në NJQV/Prefekturë, dënohen me gjobë, përkatësisht nga kryetari i NJQV-së/prefekti, nga 10 000 deri në 30 000 lekë.

7. Të drejtat dhe detyrat që përcaktohen në këtë udhëzim për kryetarët e NJQV-ve, për Bashkinë e Tiranës ushtrohen nga kryetarët e njësisve bashkiake.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij deri në datën 20 gusht 2006.

MINISTRI I BRENDSHËM
Sokol Olldashi



Formular Model A/U-999

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Bashkia/Komuna _____

QARKU _____

Datë: __/__/____

DEKLARATE

Unë i nënshkruari _____ i datëlindjes __/__/____, deklaroj se banoj në adresën e mëposhteme:

Qarku/Rrethi _____ Bashkia/Komuna _____

Rruga _____

Ndertesa _____ Apartamenti _____

Shenime te tjera _____

Përveç meje, në të njëjtën banesë, bajnojnë edhe pjestarët e familjes si mëposhtë:

Nr	Mbiemri	Emri	Atësia	Datëlindja			Lidhja familjare me deklaruesin
				Data	Muaji	Viti	
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							

Për çdo deklaram jo të saktë mbaj përgjegjësi ligjore.

Deklaruesi_____
(Emri, Mbiemri, Firma)**Plotësohet vetëm nga zyra e Urbanistikës****ZYRA E URBANISTIKES**

Në bazë të deklaramit të mësipërm, rezulton se kodi i adresës shifror zgjedhore është:

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Për Zyrën e Urbanistikës_____
(Emri, Mbiemri, Firma)

Formulari plotësohet me germa KAPITALE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
 Bashkia/Komuna _____
 QARKU _____

Prot. Nr. _____
Informacion Nr. _____ datë ____/____/____ për plotësimin e adresave shifrore zgjedhore.
 Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë/Komunes _____

Zyra e Gjendjes Civile të Bashkisë/Komunës _____, ne zbatim të pikës 2.b të Udhëzimit Nr 806 datë 03.05.2006, të Ministrit të Brendshëm, ka realizuar plotësimet e adresave shifrore zgjedhore për shtetasit e mëposhtëm:

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja		Kodi i adresës shifrore zgjedhore		Referenca e regjistrimit që kishte adresë të regullit
				Data	Muaj	Vite	Tshte	
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								
13								
14								
15								

Përgjegjës i Zyrtës së Gjendjes Civile

 (Emri, Mbiemri, Firma)



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Bashkia/Komuna

QARKU

Formular Model C/U-999

INFORMACION

Drejtuar: Kryetarit te Bashkise/Komunes për adresat e shtetasve të cilët nuk e kanë të plotë adresën e shifrore zgjedhore. Datë: ___/___/2006

Ve bazë të informacionit të mblodhur, shtetasit e mëposhtëm rezultojnë se banojnë në adresat respektive:

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja		Kodi i adresës zgjedhore	Të dhëna për vëndbanimin:	Burimi i informacionit
				Data	Viti			
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								

Personi përgjegjës

(Emri, Mbledhja, Firma)

Formulari plotësohet me germa KAPITALE



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Bashkia/Komuna _____
QARKU _____

**Informacion Nr _____ datë ____/____/____ për plotësimin e adresave shifrore zgjedhore
Kryetarit të Bashkisë/Komunes**

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë/Komunës _____, ne zbatim të pikës 2.4 të Udhëzimit Nr 806 datë 03.05.2006, të Ministrit të Brendshëm, ka realizuar plotësimet e adresave shifrore zgjedhore për shtetasit e mëposhtëm:

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja		Kodi i adresës shifrore zgjedhore		Referenca e Deklarimit të shtetasit
				Data	Viti	Ishte	Bëhet	
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								
11								
12								
13								
14								
15								

Punonjësi i Zyres së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Firma)

Formulari të plotësohet me gërma KAPITALE



Formular Model E/U-999

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Bashkia/Komuna _____

QARKU _____

Prot. Nr. _____

Datë: __/__/__

INFORMACION

Drejtuar Prefektit te Qarkut

Bashkia/Komunës _____, ne zbatim të Udhëzimit Nr 806 datë 03.05.2006, të Ministrit të Brendshëm, ka realizuar plotësimet e adresave shifrore zgjedhore për shtetasit e mëposhtëm sipas këtyre kategorive:

Nr	Lloji i plotësimit	Totali i mëparshëm	Raportimi javor	Totali
1	Nga ZGjC-të, mbi bazë të regjistrave			
2	Nga ZGjC-të, mbi bazë të deklarimeve të shtetasve			
3	Nga verifikimi i administratorëve ose kryetarëve të fshatrave			
SHUMA				

Kryetari

(Emri, Mbiemri, Firma)

Formulari plotësohet me germa KAPITALE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT _____

Prot. Nr. _____

Datë: __/__/____

INFORMACION

Drejtuar DPGjC-se

Qarku _____, ne zbatim të pikës 4 të Udhëzimit Nr 806 datë 03.05.2006, të Ministrisë të Brendshme,
ka realizuar plotësimet e adresave shifrore zgjedhore për shtetasit e mëposhtëm sipas këtyre kategorive:

Nr	Emri i Bashkisë/Komunës	Nga ZGjC-të, mbi bazë të regjistrave	Nga vetwdeklarimi i shtetasve	Nga verifikimi i admin./kryet. e fshatrave	Totali
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					
13					
14					
15					
16					
17					
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					
29					
30					
31					
32					
33					
34					
35					
Shuma					

Prefekti i Qarkut

(Emri, Mbiemri, Firma)

U D H Ë Z I M
Nr. 807, datë 3.5.2006

**PËR ADMINISTRIMIN DHE PËRDITËSIMIN E PËRBËRËSVE ZGJEDHORË TË
REGJISTRIT TË PËRKOHSHËM TË SHTETASVE TË PAREGJISTRUAR NË
REGJISTRIN THEMELTAR TË GJENDJES CIVILE TË VENDBANIMIT**

Me qëllim përcaktimin e procedurave dhe afateve për administrimin dhe përditësimin e përbërësve zgjedhorë të regjistrit të përkohshëm të shtetasve të paregjistruar në regjistrin themeltar të gjendjes civile të vendbanimit,

në zbatim të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 53, pikat 2 dhe 3, nenit 178 pika 2/3 të ligjit 9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenit 16 pika 1 të ligjit nr.8927, datë 25.07.2002, "Për Prefektin",

UDHËZOJ:

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore (NJQV) nxjerr urdhra të veçantë si më poshtë:

a) Urdhëron Zyrën e Gjendjes Civile (ZGJC) që, jo më vonë se 7 ditë nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, të evidentojë shtetasit të cilët janë të regjistruar në regjistrin e përkohshëm të shtetasve të paregjistruar në regjistrin themeltar të gjendjes civile të vendbanimit (regjistri i përkohshëm) dhe që më pas janë regjistruar në regjistrin themeltar të po kësaj njësie.

Pas këtij evidentimi, ZGJC-ja harton një listë me të gjithë emrat dhe kryen veprimet për çregjistrimin e tyre nga regjistri i përkohshëm dhe për çdo rast shënon datën kur u krye veprimi, si dhe të dhënat e regjistrit themeltar ku kanë kaluar këta shtetas (regjistri themeltar, numri, fleta).

Për të gjitha rastet e evidentuara, ZGJC-ja paraqet raport te kryetari i NJQV-së sipas formularit A/U-RP.

b) Pasi janë kryer procedurat e përcaktuara në germën (a), kryetari ngarkon punonjës të administratës së tij që, jo më vonë se 10 ditë nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, të hedhin në formularin "B/U-RP" bashkëngjitur të dhënat e anëtarëve të çdo familjeje që vazhdon të figurojë e regjistruar në regjistrin e përkohshëm të njësisë.

c) Në përfundim të procedurës dhe afatit të parashikuar në germën (b), kryetari ngarkon administratorët e lagjeve/kryetarët e fshatrave, ose punonjës së administratës së tij kur është e domosdoshme, të kontaktojnë shtetasit të cilët vazhdojnë të figurojnë të regjistruar në regjistrin e përkohshëm të njësisë.

Në rastet kur shtetasi kontaktohet, veprimet në formularin "B/U-RP" kryhen sipas këtyre rasteve:

i) për familjet të cilat deklarojnë se nuk kanë ndryshime të të dhënave të pasqyruara në formularin "B/U-RP", kryefamiljari ose në mungesë të tij një nga pjestarët madhorë të familjes firmos formularin "B/U-RP";

ii) për familjet të cilat deklarojnë se kanë ndryshime të përbërësve zgjedhorë (shtesa/pakësime të përbërjes familjare), kryefamiljari ose në mungesë të tij një nga pjesëtarët madhorë të familjes firmos formularin "B/U-RP";

Në rast se shtetasi disponon një certifikatë të gjendjes familjare në të cilën janë pasqyruar ndryshimet e ndodhura në përbërësit zgjedhorë, administratori i lagjes/kryetari i fshatit, ose personi tjetër i ngarkuar, plotëson formularin dhe e firmos atë.

Në rast se shtetasi nuk disponon një certifikatë të gjendjes familjare në të cilën të jenë pasqyruar ndryshimet e ndodhura në përbërësit zgjedhorë, shtetasi njoftohet menjëherë me shkrim sipas modelit "C/U-RP" bashkëngjitur, për t'u paraqitur brenda një periudhe jo më vonë se 7 ditë nga kryerja e njoftimit pranë ZGJC-së ku figuron i regjistruar në regjistrin e përkohshëm, së bashku me certifikatën e gjendjes familjare për të bërë ndryshimet përkatëse në këtë regjistër;

iii) kur administratori i lagjes/kryetari i fshatit, ose personi tjetër i ngarkuar, nuk kontakton me asnjë pjesëtar madhor të familjes, në formularin "B /U-RP" bëhet shënimi "E pakontaktuar", duke shënuar datën dhe orën e kryerjes së verifikimit. Pas kësaj, familja njoftohet sipas modelit "D/U-RP" bashkëngjitur duke i lënë shënim për datën dhe orën kur do të kryhet verifikimi tjetër. Kjo procedurë verifikimi kryhet jo më pak se tri herë;

iv) formulari "B/U-RP" i plotësuar sipas pikave i, ii dhe iii më sipër i dorëzohet kryetarit të NJQV-së brenda ditës së nesërme nga firmosja e tij. Kryetari i NJQV-së, jo më vonë se 24 orë nga marrja e formularëve nga administratorët e lagjeve/kryetarët e fshatrave, ose personat e tjerë të ngarkuar, ua kalon ato ZGJC-së për të bërë përditësimin e regjistrit të përkohshëm.

2. Me marrjen e formularëve, ZGJC-ja:

a) pasqyron në regjistrin e përkohshëm të dhënat sipas formularëve përkatës për çdo familje;
b) për shtetasit të cilët kanë deklaruar se kanë ndryshime në përbërësit zgjedhorë, por që nuk paraqiten në ZGJC për t'i vërtetuar ato me dokumentët përkatës, i lë të pandryshuara të dhënat e tyre në regjistrin e përkohshëm;

c) për shtetasit të cilët nuk kontaktohen në përfundim të procedurës së parashikuar në pikën 1, germa (c)/III, shënon "Nuk u kontaktua" në fletën përkatëse të regjistrit të përkohshëm.

3. ZGJC-ja i kryen drejtpërdrejt veprimet sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 edhe për shtetasit (kryefamiljarët) që paraqiten vullnetarisht pranë saj.

4. ZGJC-ja raporton te kryetari i NJQV-së çdo të premte mbi ecurinë e punës për përditësimin e regjistrit të përkohshëm sipas tabelës "E" bashkëngjitur.

5. Kryetari i NJQV-së raporton çdo të martë te prefekti i qarkut mbi ecurinë e procesit sipas tabelës "F" bashkëngjitur.

6. Prefekti kontrollon saktësinë e plotësimit të tabelave të raportuara dhe i dërgon çdo të enjte një informacion përmbledhës DPGJC-së sipas tabelës "G/U-RP" bashkëngjitur.

7. Prefekti ngarkon përgjegjësit e degës së gjendjes civile në qark për të kontrolluar, verifikuar dhe ndihmuar punonjësit e ZGJC-ve në lidhje me reflektimin e plotësimeve të mësipërme në regjistrat e përkohshëm.

8. Në rast shkeljeje të detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim, personat përgjegjës në NJQV/prefekturë dënohen me gjobë, përkatësisht nga kryetari i NJQV-së/prefekti, nga 10 000 deri në 30 000 lekë.

9. Të drejtat dhe detyrat që përcaktohen në këtë udhëzim për kryetarët e NJQV-ve, për Bashkinë e Tiranës ushtrohen nga kryetarët e njësisive bashkiake.

10. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij deri në datën 20 korrik 2006.

MINISTRI I BRENDSHËM
Sokol Olldashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 Bashkia/Komuna _____
 QARKU _____

Prot.Nr. _____

Datë: ____ / ____ /2006

Informacion nr. _____ mbi çregjistrimin nga Regjistri i Përkohshëm

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë/Komunës

Zyra e Gjendjes Civile e Bashkisë/Komunës _____, nga kontrolli i transferimeve pranë kësaj zyre, ka çregjistruar shtetasit e mëposhtëm, për arsye se ata janë tashmë banorë me banim të përhershëm të Bashkisë/Komunës sonë.

Nr.	Emri	Mbiemri	Atësia	Datëlindja		Kodi i adresës shifrore zgjedhore	Emri, numri, fleta e Regjistrit Themeltar ku janë regjistruar
				Data	Viti		
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							

Përgjegjësi i Zyrës së Gjendjes Civile

 (Emri, Mbiemri, Firma)

Formulari plotësohet me gërma KAPITALE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia/Komuna _____
QARKU _____

Formular Model B/U-RP

Prot.Nr. _____

Datë: ____ / ____ /2006

Formular mbi kontaktimin e shtetasve me banim të përkohshëm

Shtetasi _____ *pjestar madhor i familjes së* _____ *deklarohet se:*
(Emri, Atësia, Mbiemri i personit të kontaktuar) (Emri, Mbiemri i Kryefamiljarit)

"vazhdoj të jem me banim të përkohshëm së bashku me familjen time në këtë Njësi të Qeverisjes Vendore".

Nr.	Emri	Mbiemri	Atësia	Datëlindja			Kodi i adresës shifrore zgjedhore	Shënime
				Data	Muaji	Viti		
1								
2								
3								
4								
5								
6								
7								
8								
9								
10								

Deklaruesi

(Emri, Mbiemri, Firma)

Përgjegjësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Firma)

Formulari plotësohet me gërma KAPITALE



Formular Model C/U-RP

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Bashkia/Komuna _____

QARKU _____

Datë: __/__/2006

NJOFTIM

I nderuar qytetar!

Në kuadër të përditësimit të Regjistrit të përkohshëm, në zbatim të Udhëzimit Nr. 807 datë 03.05.2006, të Ministrit të Brendshëm, mbështetur edhe në deklarin tuaj, ju lutemi të paraqiteni pranë zyrës së gjëndjes civile të njësisë ku banoni nga data __/__/2006 deri më datën __/__/2006, prej orës__ deri në orën __ për të reflektuar ndryshimet e ndodhura në familjen tuaj.

Ju kujtojmë se duhet të keni me vete edhe një çertifikatë të gjëndjes familjare të lëshuar nga zyra e gjëndjes civile ku ju jeni të regjistruar, jo më herët se data 01.05.2006

Në rast mos paraqitje, deklarimi i juaj nuk do të merret parasysh.

Për çdo deklarin jo të saktë mbani përgjegjësi ligjore.

Kryetari

(Emri, Mbiemri, Firma)

Formulari Plotësohet me gërma **KAPITALE**



Formular Model D/U-RP

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Bashkia/Komuna _____

QARKU _____

Datë: __/__/2006

NJOFTIM

I nderuar qytetar!

Në kuadër të përditësimit të Regjistrit të përkohshëm, në zbatim të Udhëzimit Nr. __ datë

Personi verifikues do të vijë përsëri në shtëpinë tuaj për të ju kontaktuar më datë __/__/2006

Në rastin që keni ndryshime në përbërjen e familjes suaj, ju lutemi të siguronit një çertifikatë të gjëndjes familjare të lëshuar nga zyra e gjëndjes civile ku ju jeni të regjistruar, jo më herët se data 01.05.2006

Kryetari

(Emri, Mbiemri, Firma)

Formulari Plotësohet me gërma **KAPITALE**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

Bashkia/Komuna _____

QARKU _____

Prot. Nr. _____

Datë: __/__/2006

INFORMACIONDrejtuar: **Kryetarit të Bashkisë/Komunes**

Zyra e Gjendjes Civile të Bashkisë/Komunës _____, ne zbatim të Udhëzimit Nr 807 datë 03.05.2006, të Ministrit të Brendshëm, ka realizuar përditësimet e mëposhtëme të Regjistrit të Përkohshëm:

Nr	Lloji i plotësimit	Totali i mëparshëm	Raportimi javor	Totali
1	Shtetas të kaluar nga Regjistri i Përkohshëm në Regjistrin Themeltare			
2	Shtetas të verifikuar pa ndryshime në Regjistrin e Përkohshëm			
3	Shtetas gjithsej të verifikuar me ndryshime në Regjistrin e Përkohshëm			
4	Shtetas që kanë deklaruar ndryshimet pranë Zyrës së Gjendjes Civile			
5	Shtetas që kanë vetë deklaruar ndryshime të pa kontaktuar nga verifikimi			
SHUMA				

Përgjegjësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Firma)

Formulari plotësohet me germa KAPITALE



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Bashkia/Komuna _____

QARKU _____

Prot. Nr. ____

Datë: __/__/2006

INFORMACIONDrejtuar Prefektit te Qarkut

Bashkia/Komuna _____, ne zbatim të Udhëzimit Nr 807 datë 03.05.2006, të Ministrit të Brendshëm, ka realizuar përditësimet e mëposhteme të Regjistrit të Përkohshëm:

Nr	Lloji i plotësimit	Totali i mëparshëm	Raportimi javor	Totali
1	Shtetas te ndodhur në Regjistri i Përkohshëm sipas situatës së datës 28.02.2005	Gjithsej _____		
2	Shtetas të Kontaktuar gjithsej			
3	Shtetas të kontaktuar dhe kanë deklaruar se kanë ndryshime			
4	Shtetas që kanë deklaruar ndryshimet prane Zyrës së Gjendjes Civile			
5	Shtetas që kanë vetë deklaruar ndryshime të pa kontaktuar nga verifikimi			
SHUMA				

Kryetari

(Emri, Mbiemri, Firma)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKU _____

INFORMACION

Drejtuar DPGjC-se

Datë: __/__/2006

Qarku _____, ne zbatim të pikës 6 të Udhëzimit Nr 807 datë 03.05.2006, të Ministrit të Brendshëm, ka realizuar përditësimet e mëposhtëme të Regjistrit të Përkohshëm:

Nr	Emri i Bashkisë/Komunës	Shtetas në Regjistrin e Përkohshëm	Shtetas të Kontaktuar gjithsej	Shtetas të deklaruar me ndryshime	Shtetas të paraqitur në ZGjC-ve	Shtetas me vetëdeklarim në ZGjC-ve
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
14						
15						
16						
17						
18						
19						
20						
21						
22						
23						
24						
25						
26						
27						
28						
29						
30						
31						
32						
33						
34						
35						
Shuma						

Prefekti

(Emri, Mbiemri, Firma)

Formulari plotësohet me germa **KAPITALE**

U D H Ë Z I M
Nr. 873, datë 15.5.2006

**PËR PROCEDURAT E PASTRIMIT TË DUBLIMEVE NË REGJISTRAT THEMELTARË
TË IDENTIFIKUARA NGA LISTAT E ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET
E 3 KORRIKUT 2005**

Me qëllim përcaktimin e procedurave dhe afateve që do të zbatohen për pastrimin e dublimeve në regjistrat themeltarë, të identifikuar mbi bazën e listave të zgjedhësve për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë më 3 korrik 2005,

në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 53, pikat 1 dhe 3, nenit 178 pika 2/3 të ligjit nr.9087, datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.9297, datë 21.10.2004, ligjin nr.9341, datë 10.01.2005 dhe ligjin nr.9371, datë 14.04.2005, nenit 16 pika 1 të ligjit nr.8927, datë 25.07.2002 "Për Prefektin" dhe ligjit nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile" i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC), jo më vonë se 5 ditë nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, identifikon dublimet në listat e zgjedhësve të 3 korrikut 2005, me burim nga regjistrat themeltarë në njësi të ndryshme, i grupon ato në bazë të zyrave të gjendjes Civile (ZGJC) dhe fletë familjeve dhe ua dërgon ZGJC-ve sipas formularit A/U-DUB bashkëngjitur.

2. ZGJC-të, bazuar në të dhënat e RTH-ve, plotësojnë fushat e paplotësuara të formularit A/U-DUB.

ZGJC-të i dorëzojnë këta formularë të plotësuar çdo të martë në degët e gjendjes civile në qarqe, sipas afateve të mëposhtme:

a) të martën e dytë, nga dita e marrjes së formularëve A/U-DUB prej DPGJC-së, dorëzojnë jo më pak se 400 formularë;

b) të martën e tretë dorëzojnë sasinë e mbetur të formularëve ato ZGJC të cilat kanë deri në 1000 dublime;

c) të martën e katër, sasinë tjetër të mbetur mbi 1000 formularë.

3. Degët e gjendjes civile në qarqe, formularët e ardhur nga ZGJC-të i dorëzojnë respektivisht çdo të enjte në DPGJC.

4. DPGJC, mbi bazën e informacionit të pasqyruar në formularët A/U-DUB, bazuar në ligjin nr.8950, datë 10.10.2002 "Për gjendjen civile", i ndryshuar, në ligjin nr.9062, datë 08.05.2003 "Kodi i familjes", i ndryshuar dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre, përcakton arsyen e krijimit të dublimit dhe urdhëron rast pas rasti ZGJC-të përkatëse, të përfundojnë procedurat ligjore.

DPGJC i dorëzon këto urdhra çdo të hënë në degët e gjendjes civile të qarqeve, të cilat ua shpërndajnë ZGJC-ve përkatëse çdo të martë.

5. ZGJC-të, me marrjen e urdhrit, brenda javës të përfundojnë procedurat ligjore të urdhëruara nga DPGJC-ja duke plotësuar dokumentacionin përkatës.

6. ZGJC-të dorëzojnë dokumentacionin e përgatitur çdo të martë në degët e gjendjes civile në qarqe, me qëllim përcjelljen në ZGJC-në përkatëse.

Dega e gjendjes civile në qark shpërndan drejtpërdrejt dokumentacionin e marrë nga ZGJC-të brenda qarkut dhe dërgon në DPGJC dokumentacionin për ZGJC-të e qarqeve të tjera.

DPGJC-ja kryen shpërndarjen e këtij dokumentacioni sipas ZGJC-ve nëpërmjet degëve të gjendjes civile në qarqe.

7. ZGJC-të, jo më vonë se 3 ditë nga marrja e dokumentacionit sipas pikës 6, reflektojnë ndryshimet përkatëse në regjistrat themeltarë.

8. ZGJC-të i raportojnë kryetarëve të njësive të qeverisjes vendore (NJQV) përkatëse çdo të hënë mbi ecurinë e punës së realizuar në zbatim të këtij udhëzimi, si dhe plotësojnë dhe u dorëzojnë atyre formularin "B/U-DUB".

9. Kryetarët e NJQV-ve raportojnë çdo të martë te prefekti i qarkut mbi ecurinë e procesit, duke dorëzuar edhe një kopje të formularit B/U-DUB.

10. Prefektët ngarkojnë përgjegjësit e degëve të gjendjes civile në qark për të kontrolluar dhe ndihmuar punonjësit e ZGJC-ve në lidhje me zbatimin e këtij udhëzimi.

11. Degët e gjendjes civile në qark, pasi kontrollojnë saktësinë e plotësimit të formularëve B/U-DUB dërgojnë një kopje të tyre, si edhe një informacion mbi ecurinë e punës dhe problematikën e hasur, çdo të enjte pranë DPGJC-së.

12. Në rast shkeljeje të detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim, personat përgjegjës në NJQV/prefekturë dënohen me gjobë, përkatësisht nga kryetari i NJQV-së/prefekti, nga 10 000 deri në 30 000 lekë.

13. Të drejtat dhe detyrat e përcaktuara në këtë udhëzim për kryetarët e njësive të qeverisjes vendore për Bashkinë e Tiranës ushtrohen nga kryetarët e njësive bashkiake.

14. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Sokol Olldashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia/Komuna _____

QARKU _____

Regjistri Nr. _____ Fleta Nr. _____

INFORMACION MBI FAMILJET

Nr.	Emri	Mbiemri	Atësia	Datëlindja	Amësia	Gjendja civile	Lidhja me kryefamiljarin	Nr. rendor në fletëfamilje	
1									
2									
3									
4									
5									
6									
7									
8									
9									
10									

V
i
j
o
n

Nr.	Informacion mbi shtetas		Shënime të tjera në Regjistrë (për gratë e martuara mbiemri i vajzësisë)	
	Arsyeja	Lloji i Aktit	Data e Aktit	Numri i Aktit
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				

V
i
j
o
n

Përgjegjësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia/Komuna _____
QARKU _____

Formular Model B/U-DUB

Prot.Nr. _____

Data: ____ / ____ / ____

INFORMACION

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë/Komunës

Zyra e Gjendjes Civile e Bashkisë/Komunës _____, në zbatim të Udhëzimit Nr. _____, datë ____/05/2006 të Ministrisë të Brendshëm, ka realizuar punën e mëposhtme, në drejtim të pastrimit të dublimeve nga Regjistrat Themeltarë:

Nr.	Lloji i plotësimit	Kërkesa gjithsej të ardhura	Totali i punës së realizuar deri në një-javë më parë	Raportimi javor	Totali i përpunuar nga ZGjC-ja	Totali për tu plotësuar
1	Kërkesa të ardhura nga DPGjC-së për informacion sipas regjistrave themeltarë					
2	Kërkesa për përgatitje dokumentacioni dhe për të ua drejtuar ZGjV-ve të tjera					
3	Kërkesa për familje/shitës të cilave u bllokohen veprimet dhe janë në pritje të dokumentacionit nga ZGjC-të					
4	Dokumenta të ardhura nga ZGjC-të, pranë zyrës sonë për të kryer veprime në Regjistrat Themeltarë					
	Rezultati përmbledhës					

Formulari plotësohet me gërma KAPITALE

Përgjegjësi i Zyrës së Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Firma)

VENDIM
Nr. 28, datë 12.5.2006

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË
PRODHUAR NË HEC VITHKUQ, NGA SHOQËRIA FAVINA SHPK
DHE FAVINA 1 SHPK**

Në mbështetje të neneve 9; 8 pika 2, germa b, 26 dhe 28, të ligjit nr.9072 datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të vendimeve të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 27.5.2005 “Për dhënien e licencës për prodhimin e energjisë elektrike për shoqërinë Favina sh.p.k. për centralin e Vithkuqit”, nr.85, datë 27.12.2005 “Për transferimin e licencës nga shoqëria Favina sh.p.k., te Favina 1 sh.p.k.” nr.7, datë 16.2.2006 “Për fillimin e procedurave të shqyrtimit”, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.60, datë 29.12.2004 “Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.5.2006, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga Favina 1 sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për 3-mujorin e IV të vitit 2005 dhe viti 2006, në HEC Vithkuq, nga shoqëria Favina sh.p.k. dhe Favina 1 sh.p.k.

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1.10.2005-31.12.2005, prodhuar në HEC Vithkuq, nga shoqëria Favina sh.p.k., transferuar shoqërisë Favina 1 sh.p.k. të jetë 5.3 lekë/kWh.
2. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1.1.2006-31.12.2006, prodhuar nga shoqëria Favina 1 sh.p.k., për H/C Vithkuq, të jetë 5 lekë/kWh.
3. Ngarkohet shoqëria “Favina 1” sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Pjetër Dema

VENDIM
Nr. 29, datë 15.5.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të neneve 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.5.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Emikel sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për vitin 2005,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për shoqërinë Emikel sh.p.k. për vitin 2005.
2. Për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga Emikel sh.p.k. duke filluar nga data 18.5.2006, të funksionojë një grup pune për kryerjen e verifikimit të kostove dhe investimeve i përbërë nga:

- Lavdie Konjari, specialiste e Departamentit të Çmimeve dhe Tarifave,
 - Embrin Kollçinaku, specialist i jashtëm i ERE-s,
 - Eduard Elezi, Drejtori i Departamentit të Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun,
 - Fatbardha Mullahi, Drejtore e Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Pjetër Dema

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
 - 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
 - 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
 - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**
-
- 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) 1500**
 - 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600**
 - 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).... 1500**
 - 4. PËR TAKSAT DHE TATIMET (+suplement 2006) 1500**
-
- 1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT..... 1500**
 - 2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT..... 2000**

BOTIME TË REJA

- 1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT 500**
- 2. KODI DOGANOR 1000**
- 3. KODI DETAR 1000**

Hyri në shtyp më 18.5.2006
Doli nga shtypi më 22.5.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë